



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 50 Prot

Tiranë, më 01.06. 2012

VENDIM Nr. 15 dt. 31.05.2012

Nisur nga propozimi i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Gjirokastrë drejtuar Ministrit të MTKRS, lidhur me problematikën e shoqërisë së restaurimit "GEN RED", bazuar në nenin 17, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 31.05.2012, diskutoi mbi licensën e restaurimit të Shoqërisë së sipërpërmendur dhe bazuar në Udhëzim nr. 446, dt. 05.07.2007 "Për miratimin e dokumenteve standarte të konkurimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës", TË DHËNAT E RESTAURIMIT, pika D, "KËRKESAT E KUALIFIKIMIT", pika 3,

Vendosi:

Ti propozojë ministrit të MTKRS përjashtimin nga pjesëmarrja në procedurat e konkurimit publik për një periudhë 1 vit, duke filluar që nga data 31.05.2012.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
ALDO BUMÇI

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE